



Funded by
the European Union

Vendimet e Qeverisë së Kosovës gjatë vitit 2021 nga perspektiva sektoriale, gjinore dhe buxhetore



Mars 2022

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Vendimet e Qeverisë së Kosovës
gjatë vitit 2021 nga perspektiva
sektoriale, gjinore dhe buxhetore

Mars 2022

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— **Përmbajtja**

Hyrje	3
Vendimet e Qeverisë sipas ministrive zbatuese	4
Realizimi i Programit Legjislativ për vitin 2021	8
Ndarjet buxhetore sipas vendimeve	10
Përfundim	11



Funded by
the European Union



Hyrje

Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, filloi punën në datën 22 mars 2021. Sipas programit katër vjeçar të saj, prioritetet kyçe dhe urgjente janë menaxhimi i pandemisë së Covid-19 dhe ringjallja ekonomike. Për më shumë, sipas këtij programi, fokusi i qeverisë do të jetë në luftimin e krimit dhe korrupsionit, si dhe në transformimin ekonomik dhe social të vendit. Në këtë plan është paraqitur orientimi i përgjithshëm i qeverisjes, si dhe prioritetet e ndara sipas fushave dhe sektorëve të politikave publike.

Fushat e paraqitura sipas Programit të Qeverisë janë: shëndeti publik dhe mbrojtja sociale, sundimi i ligjit, rendi dhe siguria publike, qeverisja, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve, rritja gjithëpërfshirëse ekonomike, industria, ndërmarrësia dhe tregtia, zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të teknologjisë së informacionit (TIK), bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural, zhvillimi rajonal, mjedisi dhe planifikimi hapësinor, infrastruktura, energjia dhe minierat, arsimiti dhe shkenca, kultura, rinia dhe sporti, politika e jashtme dhe diaspora, dhe politikat e mbrojtjes.¹


Qëllimi i këtij raporti të Institutit GAP është të analizojë vendimet e Qeverisë Kurti, nga marrja e mandatit në fund të muajit mars 2021, deri në fund të vitit 2021, duke bërë ndarjen e tyre sipas institucioneve dhe sipas fushave/sectorëve. Në këtë mënyrë, do të analizohet fokusi i qeverisë në këtë periudhë bazuar në vendimet që janë marrë. Për më shumë, do të analizohet edhe aspekti gjinor në vendimet e fushës së qeverisjes, në të cilat janë caktuar zyrtarë publik në pozita të larta vendimmarrëse (sekretarë/e të përgjithshëm/e, anëtarë/e të bordeve, e të tjera). Tutje, ky raport përmban edhe një përmbledhje statistikore të realizimit të Programit Legjislativ të qeverisë për vitin 2021. Për fund, do të analizohen edhe ndarjet buxhetore gjatë kësaj periudhe, bazuar në vendimet e qeverisë.

¹ Qeveria e Kosovës (2021), Programi i Qeverisë së Kosovës 2021–2025. Burimi: <https://bit.ly/36Y2qv8>

Vendimet e Qeverisë sipas ministrive zbatuese

Që nga fillimi i mandatit të kësaj qeverie, e deri në fund të vitit 2021, u mbajtën 53 mbledhje dhe u morën gjithsej 486 vendime. Numri më i madh i vendimeve bijnë në përgjegjësinë e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për zbatim (në këtë raport, si pjesë e ZKM përveç vendimeve që janë të zbatueshme drejtpërdrejt nga ZKM, janë vendosur edhe vendimet që përfshijnë më shumë ministri zbatuese apo për të cilat nuk është cekur ndonjë institucion zbatues). Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për zbatimin e 124 vendimeve, apo 26% të të gjitha vendimeve. Institucioni i dytë me numrin më të madh të vendimeve është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me gjithsej 97 vendime, apo 20% të gjithsej vendimeve. Në vendin e tretë është Ministria e Shëndetësisë, me gjithsej 54 vendime, apo rreth 11% të gjithsej vendimeve. Ministrinë tjera me numër më të madh të vendimeve janë: Ministria e Drejtësisë (38 vendime), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (33 vendime), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (28 vendime), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (25 vendime), dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (23 vendime).²

Grafikoni 1. Numri i vendimeve sipas ministrive zbatuese (%) – nga gjithsej 486 vendime




Burimi: Zyra e Kryeministrit, 2021

² Zyra e Kryeministrit. Vendimet e Qeverisë 2021. Burimi: <https://bit.ly/3tARUSj>

Në aspekt sektorial, numri më i madh i vendimeve ishte në fushën e qeverisjes³, me gjithsej 106 vendime apo 21.8% të gjithsej vendimeve.

Grafikoni 2. Numri i vendimeve sipas sektorëve (%)



Burimi: Zyra e Kryeministrit, 2021

Një tjetër fushë e cila kishte numër më të lartë të vendimeve ishte ajo e menaxhimit të pandemisë⁴, me gjithsej 40 vendime apo 8.2% të gjithsej vendimeve. Për më shumë, menaxhimit të pandemisë iu atribuon edhe 30 vendime për fushën e shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale (6.2%), si dhe 24 vendime për ringjalljen ekonomike (4.9%). Një kategori tjetër me numër më të lartë të vendimeve ishte ajo e sundimit të ligjit, me 37 vendime, apo 7.6% të gjithsej vendimeve. Dy sektorë të tjerë të cilët kishin numër më të lartë të vendimeve ishin ai i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural me 33 vendime dhe ai i mjedisit dhe planifikimit hapësinor me 31 vendime (shih Grafikonin 2 më lartë dhe Tabelën 2 në Aneks).⁵

Nëse analizohen vendimet e Zyres së Kryeministrit, vërehet se numri më i madh i tyre është fokusuar në fushën e qeverisjes. Më saktësisht, 65 vendime nga gjithsej 124, ishin të fokusuar në fushën e qeverisjes, ku përfshihen: caktimi i anëtarëve të bordeve të agjencive apo ndërmarrjeve publike, marrëveshjet financiare ndërkombëtare me Komisionin Evropian dhe organizata/shtete të tjera, dhe aprovimet/amandamentimet e programit dhe planit të qeverisë.

³ Në fushën e qeverisjes, në këtë raport janë përfshirë: caktimi i anëtarëve të bordeve të agjencive apo ndërmarrjeve publike, marrëveshjet financiare ndërkombëtare me Komisionin Evropian dhe organizata/shtete të tjera, dhe aprovimet/amandamentimet e programit dhe planit të Qeverisë.

⁴ Në këtë kategori, janë përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me marrëveshje financiare me organizata të ndryshme ndërkombëtare për menaxhim të pandemisë, si dhe ato që kanë të bëjnë me pagesa për stafin shëndetësor dhe të sigurisë që ndërlihen me menaxhimin e pandemisë.

⁵ Zyra e Kryeministrit. Vendimet e Qeverisë 2021. Burimi: <https://bit.ly/3tARUSj>

Tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), numri më i madh i vendimeve ishte i fokusuar në ndarje të mjeteve buxhetore. Nga këto, 21 vendime bëjnë pjesë në ringjalljen ekonomike dhe kishin të bëjnë me ndarje të mjeteve buxhetore lidhur me përmbushjen e masave të planifikuara në Paket e Rimëkëmbjes dhe Ringjalljes Ekonomike. Për më shumë, 13 vendime ishin të fokusuar në menaxhimin e pandemisë, kategori kjo që ka të bëjë me marrëveshje të ndryshme të financimit me organizata ndërkombëtare për menaxhim të pandemisë. Gjithashtu, edhe shtatë vendime për ndarje buxhetore ishin në kuadër të sektorit të shëndetësisë, me një shumë rreth 30 milionë euro. Në tërësi, sipas të dhënave të llogaritura nga këto vendime, gjatë periudhës prill-dhjetor 2021 janë ndarë rreth 220 milionë euro për përballimin e pandemisë COVID-19, duke përfshirë përmbushjen e masave të pakove të rimëkëmbjes dhe ringjalljes ekonomike, si dhe ndarjet buxhetore për sektorin e shëndetësisë (shih Tabelën 1).

Tabela 1. Numri i vendimeve sipas ministrive dhe sektorëve⁶

Numri i vendimeve sipas ministrive dhe sektorëve

Ministria/Institucioni	Sektori	Vendime
Zyra e Kryeministrit	Qeverisja	65
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ringjallja ekonomike	21
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Qeverisja	16
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Menaxhimi i pandemisë COVID-19	13
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor	9
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale	7

Burimi: Zyra e Kryeministrit, 2021

Tutje, një kategori tjetër tek MFPT me numër më të madh të vendimeve ishte ajo e qeverisjes, me 16 vendime, ku kryesisht janë përfshirë vendimet lidhur me ndarje buxhetore dhe çështje administrative të buxhetit. Një sektor tjetër në të cilin është përfshirë MFPT me marrëveshje për financim si dhe ndarje buxhetore, është ai i mjedisit dhe planifikimit hapësinor, me gjithsej nëntë vendime. Nga këto të dhëna, mund të konkludohet se një pjesë e madhe e ndarjeve buxhetore nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (41 prej 97 gjithsej) ishin të lidhura me menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Ministria e Shëndetësisë (MSH), si një nga ministrinë me numrin më të madh të vendimeve (54), kishte kryesisht fokusin në situatën shëndetësore dhe menaxhimin e pandemisë në vend.

⁶ Në Tabelën 1 janë shfaqur vetëm sektorët që janë konsideruar të kenë numrin më të lartë të vendimeve

Sipas të dhënave, 27 vendime të MSH ishin të fokusuar në menaxhim të pandemisë, ku kryesisht përfshihen vendimet për masat për kontrollin, luftimin dhe parandalimin e pandemisë, dhe disa vendime për angazhim të stafit shtesë shëndetësor dhe marrëveshje me institucione ndërkombëtare sipas nevojave të krijuara nga pandemia. Për më shumë, 18 vendime të MSH janë pjesë e kategorisë së shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale, ku në pjesën më të madhe përfshihen aprovimet e projektligjeve apo plotësim-ndryshimet e tyre. Sipas të dhënave, nga këto vendime u bë aprovimi i 15 projektligjeve për plotësim-ndryshimin e ligjeve në fuqi në fushën e shëndetësisë. Tjetër, kategoria e tretë me numrin më të madh të vendimeve nga MSH është qeverisja, ku përfshihen kryesisht vendimet për caktimin e zyrtarëve në pozita të udhëheqëse në institucionet e shëndetësisë (Tabela 2).

Tabela 2. Numri i vendimeve sipas ministrive dhe sektorëve

Numri i vendimeve sipas ministrive dhe sektorëve

Ministria	Sektori	Vendime
Ministria e Shëndetësisë	Menaxhimi i pandemisë COVID-19	27
Ministria e Shëndetësisë	Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale	18
Ministria e Shëndetësisë	Qeverisja	7

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2021

Analizë e vendimeve nga aspekti gjinor

Në këtë raport janë analizuar vendimet e qeverisë edhe sipas aspektit gjinor. Më konkretisht, janë analizuar vendimet për emërimet të zyrtarëve në pozita të larta në borde dhe komisione, si dhe në pozitat e sekretarëve të përgjithshëm dhe koordinatorëve. Për emërimet në këto pozita, janë marrë gjithsej 23 vendime në mandatin e kësaj qeverie: 11 vendime ishin për emërimet në borde të ndërmarrjeve publike, shtatë për emërimet në komisione, tri për emërimet të sekretarëve të përgjithshëm dhe dy për emërimet të koordinatorëve.

Përmes këtyre vendimeve, janë emëruar gjithsej 89 zyrtarë, ku 35 prej tyre gra dhe 54 burra. Nëse analizohet si tërësi emërimi i grave në këto pozita, del se 39.3% e gjithsej anëtarëve të zgjedhur janë gra. Nga këto, 44.7% të grave janë emëruar si anëtare të bordeve, 35.1% si anëtare të komisioneve, 33.3% si sekretare të përgjithshme dhe asnjë si koordinatorë (Tabela 4).

Tabela 3. Emërimet e Qeverisë në pozita të larta sipas aspektit gjinor

Vendimet për emërimet në pozita të larta sipas aspektit gjinor

Pozita	Gra	Burra	Emërimi i grave nga gjithsej anëtarët (%)
Anëtarë/e të Bordeve	21	26	44.7%
Anëtarë/e të Komisioneve	13	24	35.1%
Sekretarë/e të Përgjithshëm	1	2	33.3%
Koordinator/e	0	2	0.0%
Gjithsej	35	54	39.3%

Burimi: Zyra e Kryeministrit

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, konkludohet se ka një progres në përfaqësimin e grave në pozita udhëheqëse, me rreth 40%, nga gjithsej emërimet e kësaj qeverie. Prej këtyre, progresi më i madh është bërë në emërimet të bordeve të ndërmarrjeve publike, ku rreth 45% e anëtarëve të emëruar janë gra. Ndërsa në pozitat e anëtarëve të komisioneve dhe sekretarëve të përgjithshëm, emërimi i grave është rreth 35%.

Një nga vendimet e marra nga Qeveria Kurti gjatë vitit 2021, më konkretisht më 26 prill 2021, në mbledhjen e nëntë, ishte anulimi i një vendimi të qeverisë paraprake të emërimit të anëtarëve të bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimet Elektronike (ARKEP), me arsyetimin se nuk është respektuar ligji për barazi gjinore.⁷ Sipas këtij ligji, kërkohet të ketë përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe institucionet tjera.⁸ Megjithatë, ky obligim ligjor nuk është zbatuar nga institucionet publike deri më tani dhe është interpretuar nga ta si jo obligativ. Sipas një analize të realizuar nga Instituti GAP gjatë vitit 2021 lidhur me zbatimin e kuotës gjinore në bordet e institucioneve publike, është konkluduar që ekziston një hendek i thellë i përfaqësimit gjinor në borde dhe pozita menaxheriale të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura.

Më konkretisht, tek ndërmarrjet publike, rreth 27% e përbërjes së bordeve janë gra, ndërsa tek agjencitë e pavarura kjo përbërje është 28%. Për më shumë, disa nga agjencitë dhe ndërmarrjet në bordet e tyre nuk kanë asnjë grua. Ky hendek ishte edhe më i shprehur për pozitën e Kryeshefit/es Ekzekutiv/e, ku vetëm dy nga 32 institucionet publike udhëhiqeshin nga gratë.⁹

Megjithatë, vendimi i qeverisë lidhur me anulimin e emërimit të anëtarëve të bordit të ARKEP është i rëndësishëm dhe paraqet një hap përpara në aspektin e përfaqësimit të barabartë gjinor në pozita udhëheqëse. Prandaj, siç është konkluduar edhe në analizën e mëhershme të GAP, vendime të tilla duhet të konsiderohen si precedent se si duhet të vazhdojë të veprojnë qeveria në këtë aspekt.¹⁰ Për më shumë, vendimet e tjera të marra gjatë kësaj periudhe tregojnë progres në këtë fushë, meqenëse përfaqësimi i grave në këto pozita është rritur; megjithatë, ende duhet të punohet në arritjen e objektivës së përfaqësimit të barabartë gjinor sipas ligjit.

Realizimi i Programit Legjislativ për vitin 2021

Në mbledhjen e 11-të të qeverisë të mbajtur më 7 maj 2021 u aprovua Programi Legjislativ për vitin 2021 që përmbante 192 projektligje. Përgjatë vitit, ky program pati ndryshime, dhe si rezultat numri i projektligjeve të planifikuara nga qeveria për vitin 2021 ra në 186.¹¹ Nga këto, sipas të dhënave nga vendimet e mbledhjeve të qeverisë, u realizua aprovimi i gjithsej 115 projektligjeve, apo rreth 62% e Programit Legjislativ.

Nga këto projektligje, numrin më të lartë e kishte Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me gjithsej 24 projektligje të aprovuara, nga 25 të planifikuara. Numër të lartë të projektligjeve të aprovuara kishte edhe Ministria e Drejtësisë me 19 projektligje të aprovuara, nga 31 të planifikuara, dhe ajo e Shëndetësisë me 16 projektligje të aprovuara, nga 18 të planifikuara (Grafikoni 3). Nëse analizohen ministritë sipas realizimit të projektligjeve të planifikuara,

7 Qeveria e Kosovës (2021), Vendimet e Mbledhjes së nëntë të Qeverisë. Burimi: <https://bit.ly/3zivTdd>

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2015) Ligji nr.05/L-020 për barazi gjinore. Burimi: <https://bit.ly/3sPgXSE>


9 Instituti GAP (2021), Sfida 50/50: Zbatimi i kuotës gjinore në bordet e institucioneve publike. Burimi: <https://bit.ly/36X4vrn>

10 Ibid.

11 Zyra e Kryeministrit. Programi Legjislativ 2021. Burimi: <https://bit.ly/364n9wN>

realizimin më të lartë (100%) e kishte Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (2/2 projektligje të realizuara). Ministritë tjera që kishin realizim më të lartë ishin ajo e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural me 96%, dhe ajo e Shëndetësisë me 89%.

Grafikoni 3. Projektligjet e planifikuara dhe të realizuara sipas ministrive gjatë vitit 2021




Burimi: Zyra e Kryeministrit, 2021

Në anën tjetër, ministria me numrin më të ulët të projektligjeve të aprovuara (duke mos përfshirë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim e cila nuk kishte asnjë projektligj të planifikuar) ishte ajo e Zhvillimit Rajonal, me asnjë projektligj të aprovuar nga një që e kishte të planifikuar. Dy ministri të tjera me numër të ulët të projektligjeve të aprovuara ishin ajo e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe ajo e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, me nga një projektligj të aprovuar. Edhe nga aspekti i përqindjes së realizimit të projektligjeve të planifikuara, ministritë me realizimin më të ulët ishin ajo e Zhvillimit Rajonal me zero projektligje, e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me rreth 8%, dhe ajo e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me 20%.

Ndarjet buxhetore sipas vendimeve

Gjatë periudhës mars-dhjetor 2021, një pjesë e madhe e vendimeve kishte të bëjë me ndarje buxhetore në ministri dhe sektorë të ndryshëm. Bazuar në këto vendime, gjatë kësaj periudhe gjithsej shuma e ndarjeve buxhetore për të gjithë sektorët ishte rreth 270 milionë euro. Marrë parasysh situatën me pandeminë, ishte e pritshme që pjesa më e madhe e shumave të ndara të ndërlidheshin me menaxhimin e pandemisë dhe ringjalljen ekonomike. Më konkretisht, gjithsej shuma e ndarjeve buxhetore për ringjalljen ekonomike ishte rreth 208 milionë euro, apo rreth 77% e gjithsej ndarjeve buxhetore. Në këtë kategori janë përfshirë vendimet që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Për më shumë, rreth 12 milionë euro apo rreth 5% e gjithsej ndarjeve buxhetore është ndarë për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Në këtë kategori, janë përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me marrëveshje financimi me organizata të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ato që kanë të bëjnë me pagesa për stafin shëndetësor dhe të sigurisë që ndërlidhen me menaxhimin e pandemisë (Grafikoni 4).

Grafikoni 4. Ndarjet buxhetore sipas sektorëve për periudhën mars-dhjetor 2021



Burimi: Zyra e Kryeministrit, 2021

Një kategori tjetër me shumë më të lartë të ndarjeve buxhetore është ajo e shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale, me rreth 30 milionë euro të ndara apo 11% të gjithsej ndarjeve buxhetore. Në këtë kategori janë përfshirë të gjitha pagesat që lidhen me sektorin e shëndetësisë (për stafin shëndetësor, barna, vaksinim e të tjera). Pjesa tjetër e ndarjeve buxhetore, në shumë prej rreth 19 milionë euro i takon sektorëve tjerë, në shuma më të vogla. Nga këto, rreth 2.5% nga gjithsej mjetet e ndara janë rialokim i mjeteve, rreth 1.7% për politikën e mbrojtjes, 1.5% për arsimin dhe shkencën, dhe rreth 1% për rendin dhe sigurinë publike.

Përfundim

Qeveria e Kosovës, që nga fillimi i këtij mandati, ka mbajtur 53 mbledhje dhe ka aprovuar gjithsej 486 vendime. Numri më i madh i vendimeve sipas institucionit zbatues i takon Zyres së Kryeministrit, me 124 vendime. Në vendin e dytë për nga numri i vendimeve, është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me gjithsej 97 vendime, përcjellur nga Ministria e Shëndetësisë me gjithsej 54 vendime. Në aspekt sektorial, numri më i madh i vendimeve ishte në fushën e qeverisjes, me 21.8% të gjithsej vendimeve. Një numër i madh i vendimeve ishte në fushat që iu atribuuan menaxhimit të pandemisë, e që janë: 8.2% nga gjithsej vendimet për menaxhim të pandemisë, 6.2% për fushën e shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale, dhe 4.9% për ringjalljen ekonomike. Një kategori tjetër me numër më të lartë të vendimeve ishte ajo e sundimit të ligjit, me 37 vendime, apo 7.6% të gjithsej vendimeve.

Në aspektin gjinor, përmes këtyre vendimeve janë emëruar gjithsej 89 zyrtarë, ku prej tyre 35 gra dhe 54 burra. Si përqindje, del se 39.3% të gjithsej anëtarëve të zgjedhur gjatë kësaj periudhe janë gra. Nëse analizohen sipas pozitive, 44.7% të grave janë emëruar si anëtare të bordeve, 35.1% si anëtare të komisioneve, dhe 33.3% si sekretare të përgjithshme. Nga të dhënat e mbledhura nga këto vendime, konkludohet se ka një progres në përfaqësimin e grave në pozita udhëheqëse, rreth 40%, nga gjithsej emërimet e kësaj qeverie. Megjithatë, ende ka hapësirë të punohet në arritjen e objektivës së përfaqësimit të barabartë gjinor sipas ligjit.

Në analizën e realizimit të Programit Legjislativ për vitin 2021, konkludohet se pas ndryshimeve përgjatë vitit, nga 186 projektligjet e planifikuara, u realizuan gjithsej 115 projektligje, apo rreth 62% e Programit Legjislativ. Ministritë me realizimin më të lartë ishin ajo e Administrimit të Pushtetit Lokal, me realizim të plotë 100% (2/2 projektligje të realizuara), ajo e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me 96% (24/25 projektligje të realizuara), dhe ajo e Shëndetësisë me rreth 89% (16/18 projektligje të realizuara). Në anën tjetër, ministritë me realizimin më të ulët ishin ajo e Zhvillimit Rajonal me 0% (0/1 projektligje të realizuara), ajo e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me rreth 8% (1/13 projektligje të realizuara) dhe ajo e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me 20% (1/5 projektligje të realizuara).

Në analizën e ndarjeve buxhetore sipas vendimeve gjatë kësaj periudhe, është llogaritur se shuma e ndarjeve buxhetore për të gjithë sektorët ishte rreth 270 milionë euro. Nga këto, pjesa më e madhe është ndarë për menaxhimin e pandemisë dhe ringjalljen ekonomike. Më konkretisht, shuma e ndarë për përmbushjen e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ishte rreth 208 milionë euro. Për më shumë, rreth 12 milionë euro janë ndarë për kategorinë e menaxhimit të pandemisë (ku përfshihen marrëveshjet e financimit me organizata te ndryshme ndërkombëtare, si dhe ato që kanë të bëjnë me pagesa për stafin shëndetësor dhe të sigurisë). Një kategori tjetër me shumë më të lartë të ndarjeve buxhetore është ajo e shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale, me gjithsej rreth 30 milionë euro të ndara.

Si përfundim, sipas analizës së paraqitur më lartë, konkludohet që fokusi i qeverisë gjatë këtij viti ishte kryesisht menaxhimi i pandemisë dhe ringjallja e ekonomisë. Për më shumë, një numër i madh i vendimeve ishte edhe në fushën e qeverisjes, ku përfshihet caktimi i zyrtarëve në pozita të larta udhëheqëse. Gjithashtu, një numër i madh i vendimeve ishte edhe në fushën e sundimit të ligjit.

Aneks

Aneks 1. Numri i vendimeve sipas ministrive


Ministria	Vendime
Zyra e Kryeministrit	124
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	12
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	11
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	33
Ministria e Drejtësisë	38
Ministria e Ekonomisë	10
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	97
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	25
Ministria për Kthim dhe Komunitete	-
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	9
Ministria e Mbrojtjes	12
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	28
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	23
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	6
Ministria e Shëndetësisë	54
Ministria e Zhvillimit Rajonal	-
Të tjera	4
GJITHSEJ	486

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Aneks 2. Numri i vendimeve sipas sektorëve

Sektor	Vendime
Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale	30
Sundimi i ligjit	37
Rendi dhe siguria publike	10
Qeverisja	106
Qeverisja lokale	13
Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore	8
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve	-
Rritje gjithëpërfshirëse ekonomike	7
Industria, ndërmarrësia dhe tregtia	25
Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të TIK	4
Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural	33
Zhvillimi rajonal	2
Mjedisi dhe planifikimi hapësinor	31
Infrastruktura	5
Energjia dhe minierat	5
Arsimi dhe shkenca	13
Kultura, rinia dhe sporti	11
Politika e jashtme dhe diaspora	28
Politikat e mbrojtjes	9
Politikat e migrimit	6
Të tjera	39
Menaxhimi i pandemisë COVID-19	40
Ringjallja ekonomike	24
GJITHSEJ	486

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës





Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

